



Prishtinë, 23.06.2020  
Kodi i ZRRE-së: V\_1266\_2020

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

**Bazuar në:**

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Nenit 25, Nenit 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084),
- Dispozitat e Nenit 9 të Kodit të Rrjetit- Dispozitat e përgjithshme,
- Dispozitat e Nenit 10 dhe 11 të Doracakut të raportimit për sektorin e energjisë,
- Kërkesën për shqyrtim dhe aprovim të Raportit të Derogimeve të Kodit të Rrjetit, Rregullave të Tregut dhe Licencës së OST të datës 04.06.2020 të Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (KOSTT),

në seancën e mbajtur me datë 23.06.2020, nxori këtë:

## V E N D I M

- I. **APROVOHET** kërkesa e KOSTT SH.A. për Derogimet e dispozitave të Kodit të Rrjetit, Rregullave të Tregut dhe Licencës së OST si në shtojcën e këtij vendimi.
- II. Dispozitat tjera të Kodit të Rrjetit, Rregullave të Tregut dhe Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmetimit mbesin në fuqi.

## Arsyetim

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 04.06.2020 ka pranuar kërkesën e KOSTT SH.A., për derogim në zbatimin e disa dispozitave nga Kodi i Rrjetit, Rregullat të Tregut dhe Licenca e OST.

❖ **Kodi i Rrjetit:**

➤ **Kodi i Planifikimit Operativ**

*Penqesat e sistemit të transmetimit, Kërkesat për rezerva, Kapacitetet interkonektive,*  
nuk mund të realizohen deri sa të fillojë operimi i KOSTT si Zonë Rregulluese. Për këto



arsye KOSTT ka kërkuar derogim dhe Bordi i ZRRE-së ka aprovuar derogimin deri me datë 31.12.2020;

➤ **Kodi i Balancit**

Dispecimi në kohë reale, Aranzhimet balancuese, nuk mund të realizohen deri sa të fillojë operimi i KOSTT si Zonë Rregulluese. Për këto arsye KOSTT ka kërkuar derogim dhe Bordi i ZRRE-së ka aprovuar derogimin deri me datë 31.12.2020;

Mospërputhja e ngarkesës me gjenerimin në kohë reale - nuk mund të realizohen në pjesën veriore të vendit deri sa të zgjidhet çështja e furnizimit të këtij rajoni. Për këto arsye KOSTT ka kërkuar derogim dhe Bordi i ZRRE-së ka aprovuar derogimin deri me datë 31.12.2020;

Rregullimin kohor - nuk mund të realizohen deri sa të fillojë operimi i KOSTT si Zonë Rregulluese. Për këto arsye KOSTT ka kërkuar derogim dhe Bordi i ZRRE-së ka aprovuar derogimin deri me datë 31.12.2020;

❖ **Rregullat Tregut**

Alokimi dhe tretimi i kapaciteteve interkonektive KOSTT është aksionarë në SEE CAO dhe do ta shfrytëzojë atë si agjent në kryerjen e obligimeve që kanë të bëjnë me ankandin, alokimin dhe transferin e të drejtave të transferit fizik. Shërbimet nga CAO nuk mund ti shfrytëzojë ende pasi që ende nuk është implementuar Marrëveshja për Kçje me ENTSO-E;

Nominimet interkonektive - Obligimet nga kjo dispozitë ndërlidhen me obligimet për Alokimin dhe Tregtimin e Kapaciteteve Interkonektive sipas Nenit 7 të Rregullave të Tregut. Obligim i njëjtte është po ashtu në Nenin 16, paragrafi 1 (Interkonektorët) i Licencës së OST (OST bënë alokimin e kapaciteteve të linjave interkonektive me sistemet tjera në harmoni me procedurat e qarta dhe transparente për alokimin dhe shfrytëzimin e linjave interkonektive).

Për këto arsye KOSTT ka kërkuar derogim dhe Bordi i ZRRE-së ka aprovuar derogimin për këto pika deri me datë 31.12.2020;

❖ **Licenca e OST**

Disponueshmëria dhe mirëmbajtja e të dhënave – Derisa të fillojë operimi i KOSTT si Zonë Rregulluese, nuk mund të bëhet publikimi i të dhënave për: Kapacitetet ndërkufitare, Funkcionimin e interkonektorëve, si dhe Menaxhimin e kongjestionëve. Për këto arsye KOSTT ka kërkuar derogim dhe Bordi i ZRRE-së ka aprovuar derogimin deri me datë 31.12.2020;

Blerja ekonomike e aseteve, shërbimeve dhe shërbimeve ndihmëse - Është përzgjedhur fituesi për ofrimin e rezervës terciare, por kjo do të mundësohet kur KOSTT të fillojë



operimin si Zonë Rregulluese në kuadër të Bllokut AK.

Për këto arsye KOSTT ka kërkuar derogim dhe Bordi i ZRRE-së ka aprovuar derogimin deri me datë 31.12.2020;

Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës sipas Raportit të Derogimeve të dispozitave të Kodit të Rrjetit, Rregullave të Tregut dhe Licencës së OST ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, ku do të publikohet edhe dokumenti.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi, palët e pakënaqura mund ti drejtohen Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

**Bordi i ZRRE-së,**

Arsim Janova, u.d. Kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Ruzhiti, anëtar

Vendimi së bashku me Raportin e derogimeve me afatet e lejuara duhet të publikohet në faqen zyrtare të ZRRE dhe të iu dërgohet palëve:

- Të licencuarit KOSTT Sh.A.
- Arkivit të ZRRE-së.